



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Nr. _____ Prot
17.10.2019

Tiranë më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[17.10.2019]

Për: **BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “SALILLARI” SH.P.K &
“BAJRAMI N” SH.P.K**

Rruga e Vjeter Vore – Tirane km 1, Vore

TIRANË

Procedura e prokurimit: Pune/Procedure e Hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-26436-06-13-2019

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Rehabilitim i segmentit rrugor ‘Mbikalimi pallati
me shigjeta-Rrethrrrotullimi Shqiponja’, loti 1”, me fondi limit *limit 2, 250, 950, 653.25*
(dy
miliard e dyqind e pesedhjetë milion e nentëqind e pesedhjetë mijë e gjashtëqind e pesedhjetë
e
*tre presje njezet e pese) lekë pa TVSH.***

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BO “2 T” SHPK & “G.P.G COMPANY” SHPK
NUIS: K0173100M / J64324443V

Vlera: 1.849.345.584,82 (nje miliard e teteqind e dyzet e nentemilion e treqind e dyzet e pese mije e peseqind e tetedhjete e kater presje tetedhjete e dy) leke pa tvsh.

2. JV “ALB-BUILDING” SHPK & “EUROTEOREMA” SHPK & “LIQENI VII” SHA & “COMMUNICATION PROGRES” SHPK

NUIS: J69102508C / J81608007S / K01730502W / K01625001C

Vlera: 1.726.144.828,77 (nje miliard e shtateqind e njezet e gjashte milion e njeqind e dyzet e kater mije e teteqind e njezet e tete presje shtatedhjete e shtate) leke pa tvsh

3. BOE “CURRI” SHPK + “ALBA KONSTRUKSION” SHPK

NUIS: J67902718S / J61812013R

Vlera: 1.990.898.426,80 (nje miliard e nenteqind e nentedhjete milion e teteqind e nentedhjete e tete mije e katerqind e njezet e gjashte presje tetedhjete) leke pa tvsh.

4. “GENER 2”

NUIS: K58615301M

Vlera: 2.228.432.216,08 (dy miliard e dyqind e njezet e tetemilion e katerqind e tridhjete e dymije e dyqind e gjashtembedhjete presje tete) lekë pa tvsh.

5. JV “GJOKA KONSTRUKSION” sha “SHANSI INVEST” shpk

NUIS: J91815014U/ J61924002T

Vlera: 1.924.025.051,67 (nje miliard e nenteqind e njezet e kater milion e njezet e pese mije e pesedhjete e nje presje gjashtedhjete e shtate) leke pa tvsh.

6. “SALILLARI” SHPK & “BAJRAMI N.” SHPK

NUIS: J62903125G / K02727202O

Vlera: 1.776.111.282 (nje miliard e shtateqind e shtatedhjete e gjashte milion e njeqind e njembedhjete mije e dyqind e tetedhjete e dy) leke pa tvsh

7. “VEGA” SHPK & “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” SHPK

NUIS: K01524006L / K91628013D

Vlera: 2.127.812.661,05 (dy miliard e njeqind e njezet e shtate milion e teteqind e

dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një presje pese) leke pa tvsh.

8. BOE “VELLEZERIT HYSA” SHPK & “BE-IS” SHPK

NUIS: K12911201C / L61621008A

Vlera: 1.786.834.087 (një miliard e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh.

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtem:

1. BO “2 T” SHPK & “G.P.G COMPANY” SHPK

NUIS: K0173100M / J64324443V

2. JV “ALB-BUILDING” SHPK & “EUROTEOREMA” SHPK & “LIQENI VII” SHA & “COMMUNICATION PROGRES” SHPK

NUIS: J69102508C / J81608007S / K01730502W / K01625001C

3. “GENER 2”

NUIS: K58615301M

4. JV “GJOKA KONSTRUKSION” sha “SHANSI INVEST” shpk

NUIS: J91815014U/ J61924002T

Pikërisht për arsyet e mëposhtme

1.Skualifikim te ofertes se paraqitur nga BO ALB-BUILDING shpk & Euroteorema Peqin shpk & Liqeni VII sha & Communication Progres shpk, sepse nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kriterëve te kerkuara ne DT dhe baze ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP.

Konkretisht;

1.1 Nje nga pjesetaret e ketij BO, me informacionin qe disponohet zyrtarisht ne ARRSH, ne momentin e hapjes se ofertave si dhe ne daten e vleresimit te tyre, rezulton se, operatori Euroteorema Peqin shpk ka aktualisht me ARRSH-ne te paperfunduar ne 70 % te volumit te punimeve te parashikuara ne kontraten me objekt: “Perfundimi i punimeve te mbetura dhe

plotesimi me rruge dytesore Nyja e Milotit”.

Edhe vete operatori Euroteorema Peqin shpk ne deklarimin e bere e pranon dhe pohon se eshte duke zbatuar punimet ne kontraten me objekt “Perfundimi i punimeve te mbetura dhe plotesimi me rruge dytesore Nyja e Milotit“ dhe nuk pretendon se i ka perfunduar ato ne me shume se 70 % te volumit te parashikuar ne kontrate.

ARRSH eshte e detyruar qe te zbatoje percaktimet ligjore ne fuqi te parashikuara ne VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku ne menyre eksplicite perjashtimisht nga çdo AK, por vetem per ARRSH-ne eshte percaktuar detyrimi qe **i ndalohet te kualifikoje e shpalle fitues operatore, te cilet kane ne proces me ARRSH duke zbatuar kontrate dhe nuk i kane perfunduar punimet ne 70 % te vleres se kontrates .**

Ne VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, shprehimisht thuhet “Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila **ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje liçence”.**

Skualifikimi per kete arsye te mosperfundimit te 70 % te volumit te puneve ne kontraten qe ka aktualisht me ARRSH-ne, eshte detyrim ligjor per KVO-ne, jo vetem sepse eshte parashikuar ne piken 2.3.1 te kriterave te veçanta per kualifikim, por edhe sepse eshte nje praktike e konsoliduar e vendimmarrjeve te ARRSH-se edhe ne procedura te meparshme prokurimi.

Keshtu, nga referimi ne percaktimet e VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, jane skualifikuar ne disa proceduara te meparshme prokurimi te zhvilluara nga ARRSH-ja, operatore qe kane patur difference me operatorin e shpallur fitues pikerisht, sepse kane qene me kontrata me ARRSH dhe te paperfunduara ne 70 % te vleres se kontrates.

Nqs ne proceduren aktuale nuk do te zbatohej ky kriter per skualifikim, çka do te thoshte qe aplikimi i 70 % te behej ne disa proceduara dhe ne disa jo, do te perbente në thelb cenim te parimit te nje procesi te rregullt ligjor e administrativ, sepse **do te cenohej parimi i sigurise juridike.**

Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton,*

ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”.

Ne rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscënimi i pritshmërive të ligjshme të operatorëve të ndryshëm që marrin pjesë në procedurë duke iu referuar praktikës së mëparshme të vendimmarrjes dhe akteve të mëparshme të ARRSH-së për skualifikim të operatorëve që kanë të paperfundura 70 % të vlerës kontratës me ARRSH.

Mosaplikimi i përcaktimeve të 70 % do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e nenit 4 të K Pr Administrative (*Parimi i ligjshmerisë*).

Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike siç është edhe ARRSH-ja.

Ky parim nënkupton në rastin konkret se zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe në mënyrë të veçantë ai i vlerësimit të ofertave do të zhvillohet në harmoni, në koherencë të plotë logjike e ligjore me dispozitatë të LPP dhe rregullave të prokurimit me dispozitatë të tjera me të cilat lidhet procedura e prokurimit e siç është rasti i VKM nr 42 /2008. Kjo VKM nr 42, si akt normativ, ka lidhje të ngushtë dhe organike me procesin e vlerësimit të ofertave, sepse lidhet me kapacitetet teknike e profesionale që duhet të disponojë operatori që zbaton punime në fushën e ndërtimit me fonde publike.

Moszbatimi i përcaktimeve të VKM 42 /2008, KREU III, pika 1 paragrafi II.b, i ndryshuar, do të ishte shkelje e parimit të ligjshmerisë si dhe parimeve të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Moszbatimi i përcaktimeve të VKM 42 /2008 KREU III, pika 1 paragrafi II.b , i ndryshuar, do të konsiderohej vlerësim sipërfaqësor e formal i kriterëve për kualifikim nderkohe që, KVO ka detyrimin që të bëjë analizë në themel dhe të arsyeshme të kriterëve për kualifikim në harmoni me bazën ligjore të aplikueshme për rastin e zbatimit të punimeve në ndërtim në kontratat të lidhura në përfundim të procedurave të prokurimit të fondeve publike.

Fakti që, ARRSH është koherente dhe e qëndrueshme në përdorimin e kësaj arsyeje, skualifikimi është detyrim i saj ligjor që rrjedh jo vetëm nga fuqia detyruese e përcaktimeve të VKM 42/2008, por edhe detyrim i zbatimit të këtij parimi të rëndësishëm të parashikuar nga K Pr Administrative si dhe LPP për qëndrueshmërinë në vendimarrje.

Nqs nga ana e ARRSH-së në procedurë të caktuara apo për operatorë të caktuar do të zbatohej përcaktimi I Kreu III, pika 1, paragrafi II b **te VKM** nr 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar kurse

ne disa raste tjera apo operatore te tjere nuk do te zbatohej, **kjo do te ishte ne kundërshtim flagrant me percaktimet e neneve, 11/Ç (parimi i ushtrimit te ligjshem te diskrecionit), 13 (parimi i drejtesie dhe paanesise) e 17 (parimi i barazise dhe mosdiskriminimit) te K Pr Administrative.**

Konkretisht ne nenin 11/Ç K PR A shprehimisht percaktohet:

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

.....

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

Edhe ne rastin e supozuar se KVO nuk do te zbatonte percaktimet e VKM 42 /2008, KREU III, pika 1, paragrafi II.b, i ndryshuar, perseri ky BO qe ka pjesetar te tij nje operator qe ka te paperfunduara 70 % te volumit te kontrates qe ka me ARRSH-ne, do te ishte e pamundur te shpallej fitues e te lidhte kontrate me ARRSH-ne.

Kjo, sepse percaktimet e mesiperme parashikojne jo vetem skualifikim, por **ne çdo kohe edhe pas lidhjes kontrates ajo do te konsiderohej absolutisht e pavlefshme dhe efektet e e vleresimit te KVO-se do te ishin nul dhe pa asnje pasoje juridike.**

Do te mjaftonte ankimi, por qofte edhe thjesht nje kerkese per konstatim pavlefshmerie absolute i cilitdo operatori apo subjekti tjetër te interesuar per kete procedure qe ARRSH apo Gjykata te detyrohej dhe konstatohej *nuliteti* (pavlefshmeria absolute) i fituesit dhe kontrates se lidhur (*neni 108 i K Pr Administrative*).

... citoj *„Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose KONTRATA TË SHPALLET ABSOLUTISHT E PAVLEFSHME, ME DETYRIMIN PËR NJOFTIM PËR NISJE TË PROCEDURËS PËR HEQJE LICENCE”.*

Referuar percaktimeve te VKM 42/2008, operatori qe nuk ka perfunduar 70 % te puneve te kontraktuara jo vetem duhet te skualifikohet apo kontrata t’i shpallet asolutisht e pavlefshme, por ARRSH-se i eshte ngarkuar edhe detyrimi per te bere njoftim per fillimin e procedures per heqje licence te cilitdo operator qe shpallet fitues lidh kontrate tjetër pa perfunduar 70 % te punimeve te kontrates qe ka me ARRSH-ne.

1.2 Dokumentacioni i paraqitur nga njeri prej pjesetareve te ketij bashkimi operatorësh, konkretisht operatori LIQENI VII sha per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.1 te kritereve te

veçanta paraqet te dhena te pasakta dhe ne kundërshtim me përcaktimet e VKM nr 42 datë 16.1.2008

Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Proçedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi

Ne piken 2.3.1 te kriterëve te veçanta per kualifikim eshte kerkuar :

... Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.3/1 Licencë të vlefshme të shoqërisë, për zbatim të punimeve (konform VKM-së nr. 42 datë 16.01.2008, e ndryshuar) me kategoritë e mëposhtme.

.....

**Shqyrtimi dhe vlerësimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në VKM-në e sipërpërmendur*

Per te deshmuar plotësimin e këtij kriteri, operatori Liqeni VII sha shpk ka paraqitur licencën NZ 4800/19 te leshuar date 08.06.2018 ku drejtues ligjor jane M Kalia dhe R Kalia.

Nderkohe qe, sipas ekstraktit te QKB drejtues ligjor i Liqeni VII sha qe nga data 12.01.2019 eshte edhe zoti N Çipllaka.

Pra, verëhet se ka mosperputhje te drejtuesit ligjor te pasqyruar ne licence me drejtuesin ligjor sipas ekstraktit te QKB.

Në kreun III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet”, pika 2 dhe pika 3 gërma ”a”, paragrafi 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “parashikohet se: 2. Elementet e licencës: a) **Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV.Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë; VI. Selinë;VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII.Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX.Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).** ”[...]

Në kreun I “Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime” pika 2 të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “parashikohet se: ”**Drejtues ligjor**-personi fizik apo personat fizikë (administrator për sh.p.k., drejtor, presidenti për sh.a., personi fizik) **të përcaktuar si të tillë nga vendimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/ ose në gjykatë**

Kreu II, pika 5 ,ku thuhet “**Brenda 30 ditëve, çdo subjekt i licencuar në zbatim ka detyrimin të depozitojë aplikimin për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim... I. Ndryshim apo shtesë të drejtuesit /ve ligjor të shoqërisë; dhe ne vijim kreu VII percakton se “Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast, komisioni heq licencën për shoqërinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, KVO (referuar praktikës se vendimarrjeve te

KPP per rastet e mosperputhjes se drejtuesit ligjor te licences me administratorin sipas QKR-se) gjykon se, licenca e lëshuar për shoqërinë “Liqeni VII sha megjithëse është lëshuar nga institucioni përgjegjës (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit) shfaq të meta dhe nuk përmbush të gjithë detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kjo sepse ;

Z N Ç është emruar administrator me date 12.01.2019 referuar dhe në zbatim të detyrimeve të mesiperme ligjore, Liqeni VII sha duhej që brenda dates 12.02.2019 (brenda 30 diteve) të pasqyronte ndryshimet perkatese në licencën e shoqërise.

Por, megjithëse ka kaluar afati ligjor për të pasqyruar ndryshimet në drejtuesit ligjore, Liqeni VII sha nuk ka aplikuar dhe bërë ndryshimin e kërkuar nga baza ligjore në fuqi.

Perputhja e drejtuesve ligjore sipas QKR-se dhe liçences së shoqërise nuk kushtezohet e nuk lidhet me kompetencat që sipas statutit i është caktuar njerit apo tjetrit administrator. VKM dhe ligji 9901/2008 “Për shoqëritë tregëtare” e përcakton qartë se secili administrator, pavarësisht kompetencave është drejtues ligjor dhe si i tillë duhet të jetë medoemos edhe në licencën e shoqërise.

Referuar pikës 5 gërmës (a) dhe (b) të Kreut II të VKM nr 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, është detyrim ligjor i çdo subjekti të licencuar në zbatim që të aplikojë për përditësimin e të dhënave.

Në rregullat e prokurimit përcaktohet se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi si edhe kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

Theksojmë se, në piken 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim është kërkuar shprehimisht:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër (pra VKM nr 42 datë 16.1.2008).

Per sa me sipër, dokumentacioni i paraqitur nga anëtarët i BO Liqeni VII sha, në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

në këtë rast kjo ka respektuar praktiken e vendimarrjeve të kpp si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve sic janë vendimet kpp 55/2016, KPP 203/2016 dhe KPP 502/2017. Madje në vendimin KPP 502/2017 operatori është skualifikuar thjesht e vetëm për këtë arsye të mosperputhjes së drejtuesit ligjor sipas ekstraktit të QKB-së me liçencën e shoqërise.

1.3 Operatori ka paraqitur vlerën e ofertes pa tvsh, duke e perlllogaritur në kundërshtim

me percaktimet e ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015** të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” **si dhe** Udhëzimit nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

(formulari i ofertes i paraqitur nga operatori ka gabime ne perlllogaritjen e vleres pa tvsh).

Konkretisht :

Sipas formularit te ofertes, shtojca 1 e DST, operatori ka deklaruar si vlere oferte 1 726 144 828.77 leke pa tvsh dhe 2 071 373 794.53 leke me tvsh.

Krahas formularit te ofertes operatori ka paraqitur edhe preventivin e punimeve.

Por, operatori ka perlllogaritur gabim vleren e ofertes pa tvsh duke mosperfshire ne te vleren e pajisjeve, te cilat sipas Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” , duhet te perfshiheshin ne vleren e ofertes pa tvsh.

Kjo, sepse:

Ne respekt të udhëzimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor, në cilësinë e tatimpaguesit investitor ka parashikuar në preventiv se për zërin PAJISJE nuk tatohet dy herë në total me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për sa kohë që pajisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohej me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), **vlera totale e tyre e pajisjeve duhet të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.**

Sa më sipër, gjykojmë se në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e ketij objekti prokurimi, ku krahas punimeve te ndertimit ka edhe pajisje, **vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të duhej te ishte vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e pajisjeve** (të cilat ofertohej së bashku me TVSH), kjo duke u bazuar edhe në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Në këto kushte, vlera e ofertes ekonomike pa TVSH e paraqitur nga BO, e cila është përlllogaritur pa perfshire vleren e pajisjeve, të cilat, referuar UMF ofertohej në vlerë totale vetëm me TVSH, është në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërcituara.

Nqs vlera e ofertes do te perlllogaritej e deklarohet konform baze ligjore ne fuqi, atehere vlera e ofertes se tij do te shtohet me vleren e pajisjeve.

Nga ana tjetër, gjykojmë se **përlllogaritja dhe deklarimi i vleres ekonomike pa tvsh duke mosperfshire ne te vleren e e pajisjeve shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale,**

çka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik ofertues në klasifikimin përfundimtar të ofertave të kesaj procedure.

Ne kete rast, KVO vepron edhe konform percaktimeve te **Vendimit KPP 600/2018** (*KPP eshte organi me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve dhe vendimet e KPP jane te detyruara per zbatim nga çdo AK qe prokuron me fonde publike*), ne te cilen eshte shprehur qarte se mosperfshirja e vleres se pajisjeve ne vleren e ofertes pa tvsh, eshte ndryshim i vleres se ofertes pa tvsh dhe perben shkak per skualifikim te ligjshem.

1.4 Tre prej pjesetareve te ketij BO nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.2/3 te kriterave te veçanta per kualifikim (*per pagesen e taksat vendore per çdo vend zhvillimi aktiviteti*).

Ne kete pike eshte kerkuar : ... **Vërtetim** (*shoqëruar me mandatin përkatës*) për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2017, 2018 & **këstin/këstet përkatëse të vitit 2019** (*konform Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”*), për vendet ku ka ushtruar & ushtron veprimtari për periudhat e sipërpërmendura.

Nga dokumentacioni i dorezuar ne sistem (*ekstrakti i QKB*) rezulton se operatori ALB-BUILDING shpk ushtron aktivitet edhe ne **Lushnje (Gradishte qe nga data 14.12.2018.** *Numri i çeshtjes: CN-035699-12-18*) dhe ne Mallkaster (*Povel Greshice*), por per keto vende zhvillim aktiviteti nuk ka arritur te paraqese vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019.

Gjithashtu, nga dokumentacioni i dorezuar ne sistem (*ekstrakti i QKB*) rezulton se operatori Euroteorema Peqin shpk ushtron aktivitet edhe ne **Lezhe** (*Shenkoll SHENKOLL Njësia Administrative Shënkoll, për shfrytëzim inerte në lumin Mat*) dhe ne **Kruje (NIKEL)**, por per keto vende zhvillim aktiviteti nuk ka arritur te paraqese vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019.

Po keshtu, sipas historikut te ekstraktit te QKB rezulton se gjate vitit 2017 ka zhvilluar aktivitet edhe ne Gramsh (*Kodovjat - Gramsh; GRAMSH; Ndertimi i rrugeve dhe urave Banje, seksioni 1 dhe 3B;deri dt 09.05.2017*), Elbasan (*Gostime; GOSTIME; Fshati Banje, ndertim i nenobjekteve te Hidrocentralit te Banjes deri dt 09.05.2017*) ; dhe Rreshen (*Nyja lidhese e rruges Milot-Lezhe-Rreshen-Thumane deri dt 09.05.2017*) dhe per keto vende nuk ka arritur te paraqese dokumentacion per te deshmuar shlyerjen e detyrimeve vendore ne keto njesi per vitin 2017.

Nga dokumentacioni i dorezuar ne sistem (*ekstrakti i QKB*) rezulton se operatori Liqeni VII sha ushtron aktivitet edhe ne **Durres.**

Operatori ka paraqitur vertetimin nr *extra date 05.04.2019* leshuar nga Bashkia Durres ku

thuhet se nuk ka detyrime te palikujduara deri daten e leshimit te vertetimit, pra 05.04.2019. Pra, detyrimet e taksat vendore per Bashkine Durrës janë paguar deri me daten 05.04.2019.

Nderkohe qe data e tenderit eshte 22.07.2019 dhe sipas nenit 14 te Ligjit 9632/2006 dhe pikes 2.2/3 te kriterave te vecanta per kualifikim do duhej qe brenda dates 20.07.2019 te ishte paguar edhe kesti i dyte, por operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion per te deshmuar se ka paguar kestin e dyte te detyrimit per vitin 2019 qe si afat maksimal ka daten 20.07.2019 (*neni 14 i ligjit 9632 /2006*) .

Sipas ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, keto taksa duhet te paguhen per çdo vend zhvillim biznesi.

Skualifikimi per kete arsye eshte ne perputhje te plote me praktiken e konsoliduar te vendimarrjeve te KPP, qe ne çdo rast ka vendosur urdherimin e AK per **skualifikim te operatoreve ekonomike qe nuk kane arritur te paraqesin vertetim per pagesen e detyrimeve vendore nga çdo njesi vendore ku janë te regjistruar sipas QKR-se.**

Konkretisht :

Ne Vendimin KPP 559/2016 , KPP ka vendosur me unanimitet te lere ne fuqi vendimin e AK per skualifikimin e operatorit Anakonda shpk , sepse : ...

citoj ...paragrafi i fundit i fq 7

*.....Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ndodhet në kushtet e përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Gjirokastrës dhe asaj të Sarandës; **ndërkohë që nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkinë Tepelenë.***

Dhe ne rastin e mesiperm KPP ka skualifikuar operatorin Anakonda shpk, sepse nuk ka paraqitur vertetim per pagesen e detyrimeve vendore ne Bashkine Tepelene, ndonese ne kete njesi operatori ka zhvilluar aktivitet vetem per periudhen 01.01.2014 deri në 27.02.2014

Gjithashtu ne :

Ne Vendimin KPP 76/2014 ne rastin e ankimit te Treshnjeva shpk,

citoj fq 4- 5 ...

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik nuk ka detyrim ligjor të

paguajë taksat vendore në qytetin, ku do të kryhet shërbimi, por ai **është detyruar të paguajë taksat vendore përkatëse, në njësitë vendore, ku ai ushtron aktivitetin sipas selive të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.** Pra, nuk është detyrim ligjor për asnjë shoqëri që të paguajë taksa vendore në qytetin, ku do të kryejë një shërbim të caktuar, nëse nuk ka atje vendndodhjen apo selinë.

Gjithashtu,

Vendimin KPP 9/2015 ka lene ne fuqi vendimin e AK per skualfikim te operatorit AD Star shpk, sepse nuk ka paguar detyrimet vendore per çdo vend biznesi te regjistruar ne QKR.

Citoj fq 5 ..

Konkretisht, operatori ekonomik “Ad - Star” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shlyerjen e taksave vendore vetëm për selinë dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit të tij, sipas ekstraktit të QKR-së, duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar tek *Kapaciteti Ekonomik e Financiar* në dokumentat e tenderit për paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2014 lëshuar nga Komuna ose Bashkia ku operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve *para hapjes së ofertave*. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme, siç mund të jetë paraqitja e ndonjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur nuk ka arritur të vërtetojë përmbushjen e kapacitetit ekonomik e financiar të kërkuar nga autoriteti kontraktor në DT.

Gjithashtu, ne Vendimin KPP 726/2015 është vendosur skualifikimi i BO Curri & Geci shpk sepse një prej pjesëtareve të këtij bashkimi nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e detyrimeve vendore për çdo njësi ku zhvillon aktivitet.

Citoj fq 13..

....Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit si edhe në përputhje me përqindjen e marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit.

Konkretisht, *operatori ekonomik “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin e tij sipas ekstraktit të QKR-së (si më sipër përcaktuar në pikën III.3.4.), duke mos përmbushur kriterin për paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas QKR të përcaktuar në dokumentat e tenderit.*

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm. Ne kete pike eshte kerkuar qe krahas vertetimit te njesise vendore perkatese te paraqitej deklarate mbi çdo vend zhvillim aktiviteti dhe regjistrimin ne QKR si vend zhvillimi aktiviteti.

Gjithashtu, ne vendimin K.P.P. 802/2018 theksohet :

....Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k. si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj vendeve ku ka ushtruar aktivitet për vitin 2015, pra, rrjedhimisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kthella” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k., nuk plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për vitet 2015, 2016, 2017.

Madje KPP nuk ka vijuar me shqyrtimin e arsyeve te tjera te skualifikimti sepse ka konsideruar se mospagimi I taksave vendore nga njeri prej pjesetareve te BO per nje pjese te periudhes se kerkuar ne DT eshte shkak i mjaftueshem per skualifikim pa qene nevoja per arsye te tjera skualifikimi.

Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Per sa me sipër, BO nuk ka arritur te paraqese dokumentacion qe deshmon plotesimin e pikes

2.2.3 te kriterëve të veçanta për kualifikim, çka përben shkak për skualifikim e ofertes së BO.

1.5 Një prej pjesëtarëve të këtij bashkimi, konkretisht operatori Communication Progress shpk, nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë për të deshmuar plotësimin e pikës 2.3/3 të kriterëve të veçanta për kualifikim (*Çertifikata ISO në përputhje me natyrën e zerave punëve të marre përsiper në akt marrvëshjen bashkepunimit*).

- Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se operatori Communication Progress shpk nuk ka arritur të paraqesë Çertifikatë ISO 39001-2012.

Natyra e punëve të marra përsiper nga operatori CP shpk kërkon që ai duhet të paraqiste edhe Çertifikatën ISO 39001-2012. Mosparaqitja e kësaj çertifikate konsiderohet mosplotësim i pikës 2.3/3 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

1.6 Operatori ALB Building shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë për të deshmuar plotësimin e pikës 2.3/4 të kriterëve të veçanta për kualifikim (nuk ka arritur të paraqesë Licencë QKL III.2.B)

Referuar natyrës dhe volumit të punimeve të marra përsiper nga ALB-BUILDING shpk në akt marrvëshjen e bashkepunimit rezulton se ky operator ka marrë përsiper të kryejë 61.86 % të punimeve. Kurse sipas ndarjes së punimeve ka marrë përsiper të kryejë punime për germim dheu, mbushje me material të germuar, punime në trotuar e piste biçikletash etj., të cilat kërkojnë edhe disponimin e licenses QKL III.2.B.

Disponimi i kësaj liçence nuk ka të bëjë vetëm me transportin e mbetjeve, por edhe me germim dheu e grumbullimin e materialeve inerteve, dherave, etj.

Mosdisponimi nga Albuilding shpk i kësaj liçence konsiderohet mosplotësim i pikës 2.3/4 të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe përben shkak për skualifikim të BO.

Kjo, sepse në nenin 74 të VKM 914/2014, pika 3, secili prej pjesëtarëve të BO kriteret ekonomik - finaciare, teknike e profesionale duhet t'i plotësojë në përputhje me % dhe natyrën e punëve të marre përsiper në akt marrvëshjen e bashkepunimit.

1.7 Operatori ALB Building shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të deshmuar plotësimin e pikës 2.3/2 të kriterëve të veçanta për kualifikim lidhur me disponimin e punonjësve të kualifikuar si teknik ndertimi, elektrikist, mekanik, pllakashtrues, betonues e karpentier, në proporcion me nr që i duhet të kishte sipas % të marre përsiper në akt marrvëshjen e bashkepunimit (61.86%).

Kështu, operatori Alb Building shpk ka paraqitur çertifikatë për **deshmimet e sigurimit teknik, të cilat janë deshmi të përdorimit të pajisjeve elektrike dhe leshohen nga subjekte**

juridikë jo publikë (privatë) me kusht që këto të fundit të jenë të certifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

E keto deshmi operatori ALB Building ka paraqitur per secilin nga profesionet e kerkuar ne piken 2.3/2 te kriterave te veçanta per kualifikim.

Por keto deshmi te paraqitura nuk provojne se personat qe i disponojne ato jane ne profesionet e kerkuara.

Kjo, sepse nuk te ben teknik ndertimi, elektrikist, mekanik apo hidraulik deshmia se je trajnuar per te perdorur pajisjet elektrike e dhene ndihmen e pare ne rast renie ne kontakt me rrymen elektrike por zanatçi, specialist, profesionist te nje fushe te caktuar te ben shkolla apo kursi profesional.

Ne ndryshim nga kualifikimi per perdorimin e pajisjeve elektrike, *“Kualifikimi profesional”* është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies te një ofrues i Agjencise se Formimit Profesional, i përmbyllur me provime dhe i certifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë).

Dokumenti qe duhet paraqitur per te deshmuar kualifikimin profesional jane: *Certifikatat/dëshmitë/diplomat*” te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Keto Çertifikata/dëshmi/diploma jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale , apo qendrat e formimit profesional, te cilat jane njohur e akredituar ligjerisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas percaktimeve te ligjit **Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”** apo shkollat profesionale e qendrat e formimit qe kane ekzistuar ne Shqiperi deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit **Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”**.

Per sa me siper, mosparaqitja e dokumentacionit si Certifikatat/dëshmitë/diplomat qe jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional, por vetem e deshmive te trajnimit per perdorim te pajisjeve elektrike konsiderohet mosplotesim i pikes 2.3/2 te kriterave te veçanta per kualifikim nga operatori ALB-BUILDING qe sipas akt marreveshjes ka marre persiper te kryeje 61.8 % te punimeve.

1.8 Operatori ka paraqitur dokument me pasaktesi dhe mosperputhje te % se ndarjes se punimeve sipas akt marreveshjes se bashkepunimit me % qe rezulton sipas ndarjes konkrete te punimeve per secilin prej operatoreve pjesemarres ne kete BO.

Ne nenin 74 te VKM 914/2014 eshte percaktuar :

Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. **Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh** ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. **Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....** 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, **ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.**

Ne zbatim te ketyre percaktimeve operatori ka paraqitur Kontraten e bashkimit te perkohshem te operatoreve te lidhur para noterit me nr 4051 rep, nr 1692 kol date 20.07.2019 pjese te te ciles eshte edhe pasqyra (*siç e konsiderojne vete ata ne pargrafën e parafundit te nenit 4 te akt marreveshjes*) “me ndarjen e punimeve per secilin partner te bashkimit.

Sipas nenit 4 te akt marreveshjes ndarja e punimeve eshte ne raportet : Alb Bulding 61.86 %, Euroteorema Peqin 30 % , Liqeni VII 7.8 % dhe Communication Progress shpk 0.34 %.

Por nqs do te mblidhen vlerat sipas ndarjes se punimeve dhe çmimeve te preventivit rezulton se kjo ndarje nuk eshte e sakte.

Madje KVO e ka patur te pamundur ta vertetoje se kjo ndarje eshte e sakte per shkak te konfuzionit qe ka shkaktuar ndarja e punimeve qe kane bere ne shumen **J2**. rezulton se sipas ndarjes punimeve ne tabelen e ndarjes puneve, zerat e preventivit;

Punime sherbimi

V. Konfigurim 3F Router ; V Konfigurim i Swichit te fibres optike ; V Konfigurim te fibres optike ; Integrimi i CCTV me serverin, jane marre persiper te kryhen edhe nga Alb Building dhe Communication Progress shpk por nuk kane percaktuar % per secilin prej ketyre operatoreve.

Mosndarja e % per keto zera , kuptohet qe i pamundeson KVO te perllogarise sakte dhe te verifikojë % e ndarjes se puneve ne nenin 4 te akt marreveshjes.

Edhe ne rastin e supozuar punime per keto zera do te kryhen 50 % me 50 % atehere % e Communication Progress shpk nuk del 0.34 %.

Po keshtu, duke iu referuar ndarjes se punimeve te parashikuara ne nenin 6 te akt marreveshjes ku keto zera i jane caktuar operatorit Communication Progress shpk atehere % e Alb Bulding del me e vogel se 61.86 %.

Qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 74 pika 3 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin

e Rregullave të Prokurimit Publik”, është që ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Për këtë shkak ndarja e përqindjes për zërat konkretë duhet të jetë strikte, e mirepërcaktuar dhe në çdo rast të përputhet me atë masë përqindje që ka marrë përsipër të realizojë secili prej anëtarëve në kontratën e bashkëpunimit.

Bazuar në këtë mospërputhje, KVO gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga ky bashkim shoqërisht (kontrata e bashkëpunimit dhe preventivi i paraqitur) nuk është hartuar sakte dhe në formën e duhur ligjore sipas parashikimeve të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe konsiderohet shkak për skualifikim.

Në këtë rast, KVO i referohet praktikës së vendimmarrjes së KPP sipas K.P.P.814/2018.

1.9 Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të sakte për të deshmuar plotësimin e pikës **2.1.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim** (nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të deshmuar kryerjen e punëve të ngjashme në vlerën dhe periudhën tre vjeçare të kërkuar në DT).

Konkretisht :

Operatori ALB BUILDING shpk që është edhe kryesuesi i këtij BO dhe ka marrë përsipër të kryejë 61.86 % të punëve, për të deshmuar plotësimin e pikës 2.1.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim ka paraqitur nenkontraten e lidhur me datën 30.09.2013 me Copri Konstruktion Enterprise W.L.L me objekt “Ndërtim i bulevardit Verior të Tiranës dhe punime civile përkatëse”.

Krahas nenkontrates, operatori ka paraqitur edhe dokumentacionin shoqëruar siç kërkohej në pikën 2.1.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Kështu ka paraqitur faturat tatimore, formularin e vlerësimit, pjesë të kontratës që punëdhënësi i tij ka me Bashkinë e Tiranës si dhe çertifikatë marrjeje e perkohshme në dorezim punimesh.

Rezulton se nuk ka paraqitur akt kollauidim punimesh, por pavaresisht kësaj mungese, nga dokumentat e tjera të paraqitura rezulton se vlera e punimeve të kësaj nenkontrate të realizuara gjatë afatit tre vjeçar të njohur në DT nuk është dhe nuk plotëson as kërkesën për një kontratë të vetme në vlerën 1 100 000 000 lekë dhe as si shumatorë kontratash në vlerën 4, 200, 000, 000 lekë.

Kështu, punimet e nenkontrates kanë filluar me 30.09.2013, por për efekt të llogaritjes së eksperiencës së ngjashme merren vetëm vlera e punimeve të kryera gjatë tre vjeçarit të fundit.

Nga faturat e paraqitura per punimet e realizuara rezulton se ne total vlere e puneve te realizuar ne vitet 2016 deri daten 20.06.2017 qe sipas formularit te vleresimit te paraqitur eshte data e perfundimit pjesor te puneve te marra ne dorezim eshte 1 002 165 187 leke.

Ne perlllogaritje jane perfshire faturat nga data 29.01.2016 deri fatura e fundit e kesaj periudhe date 30.06.2017.

Ne perlllogaritjen e ketij afati trevjecar, KVO i referohet praktikes se vendimarrjeve te **KPP sic eshte rasti i K.P.P. 521/2016, K.P.P. 874/2016 etj.**

Edhe nqs i shtojme kesaj vlere te nenkontrates edhe pjesen takuese prej 55 % te kontrates me objekt “Ndertim rruge mbi kanal K 192 ndricim e trotuar” realizuar ne Bashkine Durrës ne JV me Liqeni VII, perseri Alb-Bulding nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme ne disa kontrata me vlere totale 4, 200, 000, 000 lekë.

Nga sa me siper, rezulton se operatori Alb-Building nuk ploteson piken 2.1.2 te kriterave te vecanta per kualifikim, sepse vlere e punimeve te realizuara gjate tre viteve te fundit sipas dokumentacionit te paraqitur nuk permbush asnje kontrate te vetme 1 100 000 000 leke dhe as si shumatore kontratash ne vleren 4, 200, 000, 000 lekë dhe kjo referuar nenit 74 te VKM 914/2014 perben shkak te ligjshem per skualifikim.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Alb-Building” shpk & “Euroteorema Peqin” shpk & “Liqeni VII” sha & “Communication Progress” shpk janë krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit nr. 4051 repertori dhe nr. 1692 koleksioni. Operatori ekonomik “Alb Building” shpk ka marrë përsipër 61.86 %. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, kapaciteti teknik parashikohet se:

*Sa i përket **përvojës së mëparshme:***

2.1/2 Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë dëshmi se ka realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të vogël se 1, 100, 000, 000 lekë, pa tvsh.*
- b) punë të ngjashme, ku vlere monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 4, 200, 000, 000 lekë, pa tvsh.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e

tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Ndërsa pika “b” të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Si dëshmi të paraqiten:

- *Për kontrata të realizuara me autoritete publike:*

- 1. Formulari i vlerësimit;*
- 2. Kontrata/t;*
- 3. Situacioni përfundimtar;*
- 4. Akti i kolaudit*
- 5. Faturat tatimore përkatëse për cdo situacion.*

- *Për kontrata të realizuara me sektorin privat:*

- 1. Formulari i vlerësimit;*
- 2. Kontrata/t;*
- 3. Leja e ndërtimit;*
- 4. Situacioni përfundimtar;*
- 5. Akti i kolaudit*
- 6. Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion.*

Në nenin 74 pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: *3.Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”* Në rastin konkret operatori ekonomik “Alb Bulding” shpk në cilësinë e operatorit ekonomik që ka përqindjen më të madhe duhet të dëshmojë eksperiencë të ngjashme në një kontratë të vetme sa 50 % e vlerës së fondit limit.

Në plotësim të KVK, anëtari i BOE “Alb Building” shpk ka dorëzuar në SPE Kontratë lidhur mes autoritetit kontraktor Bashkia Tiranë dhe shoqërisë Copri Enterprises VVLL. Së pari, anëtari i BOE nuk ka dorëzuar kontratën e plotë të lidhur mes autoritetin kontraktor dhe kontraktorit, pasi nuk janë paraqitur kushtet e posaçme dhe kushtet e përgjithshme të kontratës, përfshirë edhe volumin e punimeve, specifikimet dhe grafikun e punimeve. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nuk provohet se deri në çfarë përqindje është lejuar nënkontraktimi në kontratën bazë mes Bashkisë Tiranë dhe Kontraktorit. Së dyti, është dorëzuar Formulari i Vlerësimit (Shtojca 8), në të cilën deklarohet se kontraktori është Shoqëria “Copri Construction Enerprise VVLL me NUIS L19604501O (referuar verifikimit në QKB-degë e shoqërisë së huaj). Për nënkontraktorin “Alb Building” shpk nuk jepet asnjë informacion mbi përqindjen e nënkontraktimit të pranuar nga institucioni publik. Është dorëzuar kontrata e nënkontraktimit midis Copri Construction Enerprise VVLL dhe shoqërisë “AlbBuilding” shpk ku rezulton se nënkontraktori ka marrë përsipër 96.5 % së bashku me faturat të lëshuara nga shoqëria Copri Construction Enerprise VVLL dhe të nënkontraktorit dejtuar kontraktorit. Në lidhje me faturat e dorëzuara:

1. Faturat e dorëzuara para muajit Korrik 2016 si datë e zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk merren në konsideratë si dëshmi e eksperiencës së ngjashme në tre vitet e fundit pasi janë jashtë afatit të parashikuar në KVK dhe në nenin 26 pika 6 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Minsitrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin KPP 521/2016.
2. Në lidhje me faturat e tjera të lëshuara nga nënkontraktori për kontraktorin brenda periudhës që faturat konsiderohen të ngjashme janë dorëzuar:
 - a) Fatura datë 29.07.2019 me vlerë 128,176,859 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
 - b) Fatura datë 31.08.2016 me vlerë 28,287,341 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
 - c) Fatura datë 30.09.2016 me vlerë 35,225,145 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
 - d) Fatura datë 31.10.2016 me vlerë 154,012,431 lëshuar për subjektin me NUIS **L51623028A**

- e) Fatura datë 30.11.2016 me vlerë 81,205,197 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
- f) Fatura datë 30.12.2016 me vlerë 9,146,957 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
- g) Fatura datë 31.01.2017 me vlerë 36,435,225 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
- h) Fatura datë 28.02.2017 me vlerë 50,249,760 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
- i) Fatura datë 31.03.2017 me vlerë 51,906,396 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
- j) Fatura datë 28.04.2017 me vlerë 224,047,463 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O
- k) Fatura datë 31.05.2017 me vlerë 13,873,904 lëshuar për DSHH me NUIS L19604501O

Total: 608,304,487 pa TVSH

Faturat duke nisur nga data 30.06.2017 e në vijim (deri në faturën e datës 28.02.2019) janë lëshuar për subjektin me NUIS K89203501D.

Në lidhje me faturat e lëshuara për NUIS **L51623028A** (Combined Group Contracting Company (K.S.C.) degë e shoqërisë së huaj) **dhe NUIS K89203501D** (Copri Construction Enterprises Ë.L.L & Alb Building **shoqëri e thjeshtë**) janë lëshura për **subjekte juridike të cilat nuk shfaqen në cilësinë e kontraktorit** “Copri Construction Enerprise VV.LL me NUIS L19604501O (referuar verifikimit në QKB-degë e shoqërisë së huaj e cila gëzon të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë mëmë) dhe/ose nuk është dorëzuar asnjë dokument provues mbi nënkontraktimin nga kontraktori të kontratës/pjesë të kontratës për subjekte të treta dhe që këto të fundit të jenë miratuar nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, anëtar i BOE “Alb Building” shpk ka dëshmuar eksperiencë të ngjashme për punime me vlerë **Total: 608,304,487 pa TVSH vlerë më e ulët se sa ajo e kërkuar në KVK.**

1.10 Nje nga operatorët pjesë e këtij BO, konkretisht operatori CP shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të sakte për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim lidhur me listë pagesat e punonjësve.

Rezulton se, liste pagesat e paraqitura nga CP shpk, jane fshire ne gjysmen e faqes per te gjithë liste pagesat e paraqitura duke i pamundesuar KVO te marre te plote informacionin qe percjell gjysma e faqes se liste pageses, çka vjen ne kundërshtim me percaktimet e bazes ligjore ne fuqi per hartimin e liste pagesave.

Ne piken 2.3.2 te kriterëve te veçanta per kualifikim shprehimisht eshte kerkuar:

*Të paraqiten: Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve ku të specifikohet numri i punonjësve për çdo muaj dhe **Listëpagesat përkatëse të plotësuar rregullisht sipas formatit dhe përcaktimeve nga legjislacioni në fuqi për secilin nga muajt për periudhën e mësipërme.***

Fshirja e gjysmes se faqes se liste pagesave i ben ato dokumenta te pasakta.

Ne shtojca 12 e DST thuhet: ***Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

1.11 Nje nga pjesetaret e ketij BO, konkretisht operatori Liqeni VII shpk ka bere deklarim te pasakte lidhur me kontratat e lidhura dhe/ose ne proces. Keshtu nga buletinet e fundit te app.gov.al rezulton ky operator eshte shpallur fitues ne Bashkine Kamez ne JV me Ndregjoni shpk si dhe ne Bashkine Kurbin, te cilat nuk i ka deklaruar te shtojca 11 qe ai ka paraqitur.

Ne shtojca12 e DST thuhet: ***Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

1.12 Operatori LIQENI VII shpk ka deklaruar se ve ne dispozicion te realizimit te punimeve per kete kontrate vetem dy kamiona dhe nje kamioncine, mjete te pamjaftueshme lidhur me volumin e punimeve qe ai ka marre persiper te kryeje. Sipas akt marreveshjes ky operator ka marre persiper te kryeje, te gjitha zerat e transportit te dheut per secilin nga akset nga 1 – 13. Volumi i ketyre zerave eshte teper i madh dhe mjetet qe ai ve ne dispozicion jane te pamjaftueshme per te perballuar gjithë volumin qe parashikohet ne preventiv.

Ne keto kushte, ky operator nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote per te deshmuar se ka ne dispozicion kapacitetin e mjaftueshem teknik (mjete e makineri) ne proporcion me volumin dhe natyren e zerave te punimeve te marre persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit.

Per sa me siper, mbeshtetur ;

Ne nenin 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

Ne shtojca 12 e DST thuhet: ***Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim***

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.*

1.13 Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë **“Alb Building” shpk & “Euroteorema Peqin” shpk & “Liqeni VII” sha & “Communication Progress” shpk** janë krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit nr. 4051 repertori dhe nr. 1692 koleksioni. Referuar elementëve konkretë të bashkëpunimit rezulton se anëtarëi i BOE “Liqeni VII” sha ka marrë përsipër 7.8 % të punimeve dhe konkretisht:

Në akset 1,2,3,4,5,7A,7B,8,9,10,11,12,13 në seksionet respektive punime gërmimi zërin “Transport Dheu me auto deri në 5 km” me vlerat përaktëse sipas preventivit të dorëzuar:

Aksi 1	49,591,080
Aksi 2	21,998,100
Aksi 3	26,200,200
Aksi 4	9,301,992
Aksi 5	16,739,976
Aksi 7A	267,846
Aksi 7B	1,411,524
Aksi 8	1,545,606
Aksi 9	2,003,628
Aksi 10	136,644
Aksi11	867,192

Aksi 12 167,556

Aksi 13 43,290

Totali 130,274,634

X 3% = 3,908,239.02

Totali = 134,182,873.02

% 1,726,144,828.77

= 7.77 %

Pra, referuar Formularit të Ofertës, rezulton që anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” sha ka marrë përsipër referuar Preventivit **7.77%**, e cila është më e vogël se **7.8%** që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM 914/2014 e cila parashikon se “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Sa më sipër, anëtari i BOE ka marrë përsipër kryerjen e shërbimit në një vlerë më të vogël se angazhimi i marrë përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit çka bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM. Të nëjtin qëndrim ka mbajtur KPP edhe në Vendimet KPP 823/2016, KPP.*

Oferta e BO ALB Building shpk & Euroteorema Pegin shpk & Ligeni VII sha & Communication Progres shpk skualifikohet .

2. **Skualifikim te operatorit GENER 2 shpk**, sepse me informacionin qe disponohet zyrtarisht ne ARRSH, ne momentin e hapjes se ofertave si dhe ne daten e vleresimit, rezulton se operatori Gener 2 shpk ka aktualisht me ARRSH-ne te paperfunduar ne 70 % te volumit te punimeve te parashikuara ne kontraten me objekt: “Ndertim By Pass Vlore”.

Edhe vete operatori ne deklarimin e bere pranon e pohon se eshte duke zbatuar punimet ne kontraten me objekt “Ndertim By Pass Vlore” dhe nuk pretendon se i ka perfunduar ato ne me shume se 70 % te volumit te parashikuar ne kontrate.

ARRSH eshte e detyruar qe te zbatoje percaktimet ligjore ne fuqi te parashikuara ne VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku ne menyre eksplicite e perjashtimisht nga çdo AK, por vetem per ARRSH-ne eshte percaktuar detyrimi qe i ndalohet te kualifikoje e shpalle fitues operatore, te cilet kane ne proces me ARRSH duke zbatuar kontraten dhe nuk i kane perfunduar punimet ne 70 % te vleres se kontrates.

Ne VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, shprehimisht thuhet “Përfundim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila **ndalohe**t të kualifikoje si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% përqind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje liçence”.

Skualifikimi per kete arsye te mosperfundimit te 70 % te volumit te puneve ne kontraten qe ka aktualisht me ARRSH-ne eshte detyrim ligjor per KVO-ne, jo vetem, sepse eshte parashikuar ne piken 2.3.1 te kriterave te veçanta per kualifikim, por edhe sepse eshte nje praktike e konsoliduar e vendimarrjeve te ARRSH-se edhe ne procedura te meparshme prokurimi.

Keshtu nga referimi ne percaktimet e VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, jane skualifikuar ne disa proceduara prokurimi te zhvilluara nga ARRSH-ja, operatore qe kane patur difference me operatorin e shpallur fitues pikerisht, sepse kane qene me kontrata me ARRSH dhe te paperfunduara ne 70 % te vleres se kontrates.

Nqs ne proceduren aktuale nuk do te zbatohej ky kriter per skualifikim, çka do te thoshte qe aplikimi i 70 % te behej ne disa proceduara dhe ne disa jo do te perbente në thelb cenim te parimit te nje procesi te rregullt ligjor e administrativ, sepse do te cenohej parimi i sigurise juridike.

Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr.

12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se ***“Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”.***

Ne rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscënimi i pritshmërive të ligjshme të operatoreve të ndryshëm që marrin pjesë në procedurë duke iu referuar praktikës dhe akteve të mëparshme të ARRSH-se për skualifikim të operatoreve që kanë të paperfundura 70 % të vlerës kontratës me ARRSH .

Mosaplikimi i përcaktimeve të 70 % do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e nenit 4 të K PR Administrative (*Parimi i ligjshmerisë*)

Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike sic është edhe ARRSH-ja .

Ky parim nënkupton në rastin konkret, se zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe në mënyrë të veçantë ai i vlerësimit të ofertave do të zhvillohet në harmoni, në koherencë të plotë logjike e ligjore mes dispozitave të LPP dhe rregullave të prokurimit me dispozitat e tjera me të cilat lidhet procedura e prokurimit e siç është rasti i VKM nr 42 /2008.

Kjo VKM nr 42 si akt normativ ka lidhje të ngushtë dhe organike me procesin e vlerësimit të ofertave, sepse lidhet me kapacitetet teknike e profesionale që duhet të disponojë operatori që zbaton punime në fushën e ndërtimit me fonde publike.

Moszbatimi i përcaktimeve të VKM 42 /2008, KREU III, pika 1 paragrafi II.b, i ndryshuar, do të ishte shkelje e parimit të ligjshmerisë si dhe parimeve të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Moszbatimi i përcaktimeve të VKM 42 /2008 KREU III, pika 1 paragrafi II.b , i ndryshuar do të konsiderohej vlerësim sipërfaqësor e formal i kriterëve për kualifikim nënkohë që KVO ka detyrim që të bëjë analizë në themel dhe të arsyeshme të kriterëve për kualifikim në harmoni me bazën ligjore të aplikueshme për rastin e zbatimit të punimeve në ndërtim në kontratat të lidhura në përfundim të procedurave të prokurimit të fondeve publike.

Fakti që ARRSH është koherente dhe e qëndrueshme në përdorimin e kësaj arsyeje skualifikimi është detyrim i saj ligjor që rrjedh jo vetëm nga fuqia detyruese e përcaktimeve të VKM 42/2008, por edhe detyrimi i zbatimit të rëndësishëm të parashikuar nga K Pr Administrative si dhe LPP për qëndrueshmërinë në vendimarrje.

Nqs nga ana e ARRSH-se në procedurë të caktuar apo për operatore të caktuar do të zbatohet përcaktimi I Kreu III, pika 1, paragrafi II b ***te VKM*** nr 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, kurse në disa raste tjera apo operatore të tjerë nuk do të zbatohet, **kjo do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e nëneve, 11/Ç (parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit), 13 (parimi i drejtësisë dhe paanësisë) e 17 (parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit) të K Pr Administrative.**

Konkretisht në nenin 11/Ç K PR A shprehimisht përcaktohet :

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

.....

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

Edhe në rastin e supozuar se KVO nuk do të zbatonte përcaktimet e VKM 42 /2008, KREU III, pika 1, paragrafi II.b, i ndryshuar, perseri ky BO që ka pjesë një operator që ka të paperfunuara 70 % të volumit të kontratës që ka me ARRSH-ne do të ishte e pamundur të shpallej fitues e të lidhte kontratë me ARRSH-ne.

Kjo, sepse përcaktimet e mesiperme parashikojnë jo vetëm skualifikim, por **ne çdo kohë edhe pas lidhjes kontratës, ajo do të konsiderohej absolutisht e pavlefshme dhe efektet e e vleresimit të KVO-se do të ishin nul dhe pa asnjë pasoje juridike.**

Do të mjaftonte ankimi, por qoftë edhe thjesht një kërkesë për konstatim pavlefshmërie absolute i cilido operatori apo subjekti tjetër të interesuar për këtë procedurë që ARRSH apo Gjykata të detyrohej dhe konstatohet *nuliteti* (pavlefshmëria absolute) i fituesit dhe kontratës së lidhur (*neni 108 i K Pr Administrative*).

... citoj *„Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose KONTRATA TË SHPALLET ABSOLUTISHT E PAVLEFSHME, ME DETYRIMIN PËR NJOFTIM PËR NISJE TË PROCEDURËS PËR HEQJE LIÇENCE”.*

Referuar përcaktimeve të VKM 42/2008 operatori që nuk ka përfunduar 70 % të punëve të kontraktuara jo vetëm duhet të skualifikohet apo kontrata t’i shpallet absolutisht e pavlefshme, por ARRSH-se i është ngarkuar edhe detyrimi për të bërë njoftim për fillimin e procedurës për heqje licence të cilindo operatori që shpallet fitues lidh kontratë tjetër pa përfunduar 70 % të punimeve të kontratës që ka me ARRSH-ne.

3.2 Operatori duhet të skualifikohet edhe mbështetur në nenin 45 të LPP sepse ka detyrime të papaguara të sigurimeve shoqërore. Kështu operatori ka paraqitur vertetimin nr T01221114 datë 09.07.2019 të leshuar nga drejtoria tatimore ku është shkruar se operatori ka detyrime të papaguara sigurimesh shoqërore në Shumen 9 751 530 leke.

3.3 Në nenin 45 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij” Në shtojcën 8 “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të

përgjithshme të Kualifikimit/Pranimi” parashikohet se: • Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë. Operatori Ekonomik “Gener 2” shpk ka dorëzuar shtojcën 8 “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të Kualifikimit/Pranimi” ku ka deklaruar se vetëm z. Bashkim Ulaj nuk ka qenë i dënuar me vendim të të formës së prerë. Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin e Regjistrimit Tregëtar rezulton se aksionerë të shoqërisë janë: Z. Astrit Ulaj aksioner në masën 33 %, Z. Ahmet Ulaj 33 %, të cilët kanë kompetenca vendimmarrëse për shoqërinë dhe për të cilët nuk është deklaruar se nuk kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë në përputhje me nenin 45 të ligjit për prokurimin publik dhe shtojcës 8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

3.4 Në shtojcën mbi ndryshimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit është parashikuar

2.3/5 Si dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
13	<i>Autovinç me kapacitet ngrites mbi 200 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
14	<i>Rimorkiator per transport mjetesh mbi 30 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
15	<i>Automjet per pastrim / fshirje asfalti (Fshese)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Impiant Betoni jo me larg se 70 km nga objekti.</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
2	<i>Impiant asfalti jo me larg se 70 km nga objekti.</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
3	<i>Impiante per thyerje dhe seleksionim materiale inertesh</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>
4.	<i>Impiant per prodhim tubo betoni</i>	<i>në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi</i>	<i>Cope 1</i>

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesinë e mjetit:- certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese;

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo fatura e zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.

Për fabrikën e asfaltit dhe të betonit, nëse është në pronesi, duhet të paraqitet vendndodhja (në distance teknikisht të pranueshme nga objekti jo më shumë se 70 km, për të garantuar hedhjen në veprë brenda kushteve teknike).

Për impiantin e asfaltit dhe të betonit, një e inerteve dhe impiantin e prodhimit të tubave të betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit dhe të betonit, një e inerteve dhe impiantin e prodhimit të tubave të betonit mund të paraqesë edhe kontratën e vlefshme furnizimi me operatore ekonomike. Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që verteton ekzistencën dhe pronesinë e impiantit.

Për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme duhet të paraqitet certifikata perkatese e leshuar nga institucioni kompetent.

Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë gjatë fazës vlerësimit të ofertës e deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.10.

Makinëritë e mësipërme (me përjashtim të fabrikës së asfaltit dhe të betonit, një e inerteve dhe

impianitit te prodhimit te tubove te betonit) nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues. (Të paraqitet Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese, ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qira me qëllim verifikimin).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën te verifikojë vërtetësinë e informacionit te paraqitur.

Në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit bashkimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me mjetet e mëposhtme ka dorëzuar:

a) Në lidhje me disponueshmërinë e autovinçave

Shtojca 9 “Deklaratë mbi Disponueshmërinë e Mjeteve”

Operatori ekonomik “Gener 2” shpk ka deklaruar disponueshmërinë e mjetit

1. Kontratë qiraje me Elevator Podgorice për mjetet BG 99300 BG 995 00 shoqëruar me vërtetim për regjistrimin e mjetit. Referuar KVK është parashikuar se për mjetet e regjistruara në regjistrat publikë duhet të paraqiten *çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese.* Gjithashtu Certifikata e Pronësisë/ Leja e Qarkullimit janë akte të lëshaur nga një ent publikë në Republikën e Serbisë. Në ligjin Nr. 9060, datë 08.05.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventen për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja” është përcaktuar: Neni 1- Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë. Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare: a)dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretaritë e gjykatave dhe zyrat përmbartimore; b) dokumentet administrative; c) aktet noteriale; d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë se firmave. Neni 2- Çdo Shtet Palë përjashton nga legalizimi dokumentet e lëshuara në territorin e tij mbi të cilat zbatohet kjo Konventë. Në kuptim të kësaj Konvente, legalizimi nënkupton vetëm aktin e formalitetit, me anë të të cilit agjentët diplomatikë ose

konsullorë të shtetit, në territorin e të cilit lëshohet dokumenti, vërtetojnë autenticitetin e firmës, cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka firmosur dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës dhe pullës që bart. Neni 3- Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i firmës, cilësia në të cilën ka vepruar personi që firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai bart, formaliteti i vetëm që mund të kërkohej është paraqitja e një çertifikate, të përshkruar në nenin 4, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin. Neni 4- Çertifikata e përmendur në nenin 3 paragrafi i parë vendoset për se gjati në një qoshe të dokumentit, sipas modelit bashkëngjitur kësaj Konvente. Megjithatë ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon dhe në një gjuhë të dytë, titulli, çertifikata, duhet të jenë në gjuhën frënge "Apostille" (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961). Dokumentacioni i mësipërm nuk është dorëzuar i legalizuar me vulë apostile. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin KPP 229/2018.

Per sa me sipër, KVO ka vendosur skualifikimin e ofertes se Gener 2 shpk.

3. Skualifikim të BO 2T shpk & GPG shpk sepse, me informacionin që disponohet zyrtarisht në ARRSH , në momentin e hapjes së ofertave si dhe në datën e vlerësimit , rezultoi se , operatori Gener 2 shpk ka aktualisht me ARRSH-në të përfunduar në 70 % të volumit të punimeve të parashikuara në kontratën me objekt ; “ Nderim By Pass Tepelene loti I “

Edhe vete operatori në deklarinë e bërë pranon e pohon se është duke zbatuar punimet në kontratën me objekt “Nderim By Pass Tepelene loti I “ dhe nuk pretendon se I ka përfunduar ato në më shumë se 70 % të volumit të parashikuar në kontratë.

ARRSH , është e detyruar që të zbatojë përcaktimet ligjore në fuqi të parashikuara në VKM nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku në mënyrë eksplicite e përjashtimisht nga cdo AK, por vetëm për ARRSH-në , është përcaktuar detyrimi që , I ndalohet të kualifikojë e shpallë fitues operatore të cilët kanë në proces me ARRSH duke zbatuar kontratë dhe nuk I kanë përfunduar punimet në 70 % të vlerës së kontratës .

Në VKM nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, shprehimisht thuhet “Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallat

absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.

Skualifikimi për këto arsye të mosperfundimit të 70 % të volumit të punëve në kontratën që ka aktualisht me ARRSH-në, është detyrim ligjor për KVO-në, jo vetëm sepse është parashikuar në pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim, por edhe sepse është një praktike e konsoliduar e vendimarrjeve të ARRSH-së edhe në procedura të mëparshme prokurimi.

Kështu nga referimi në përcaktimet e VKM nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, janë skualifikuar në disa procedura prokurimi të zhvilluara nga ARRSH-ja operatorë që kanë patur diferencë me operatorin e shpallur fitues, pikërisht, sepse kanë qenë me kontratë me ARRSH dhe të përfunduara në 70 % të vlerës së kontratës.

Nqs në procedurën aktuale nuk do të zbatohet ky kriter për skualifikim, çka do të thoshte që aplikimi i 70 % të bëhet në disa procedura dhe në disa jo, do të përbente në thelb cenim të parimit të një procesi të rregullt ligjor e administrativ, sepse do të cenohej parimi i sigurisë juridike.

Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se **“Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”.**

Në rastin konkret, parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscënimi i pritshmërive të ligjshme të operatorëve të ndryshëm që marrin pjesë në procedurë duke iu referuar praktikës dhe akteve të mëparshme të ARRSH-së për skualifikim të operatorëve që kanë të përfunduara 70 % të vlerës së kontratës me ARRSH.

Mosaplikimi i përcaktimeve të 70 % do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e nenit 4 të KPR Administrative (*Parimi i ligjshmerisë*).

Parimi i ligjshmerisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike siç është edhe ARRSH-ja.

Ky parim nënkupton në rastin konkret, se zhvillimi i procedurave të prokurimit dhe në mënyrë të veçantë ai i vlerësimit të ofertave do të zhvillohet në harmoni, në koherencë të plote logjike e ligjore me dispozitatë të LPP dhe rregullave të prokurimit me dispozitatë e tjera me të cilat lidhet procedura e prokurimit e sic është rasti i VKM nr 42 /2008. Kjo VKM nr 42 si akt normativ ka lidhje të ngushtë dhe organike me procesin e vlerësimit të ofertave, sepse lidhet me kapacitetet teknike e profesionale që duhet të disponojë operatori që zbaton punime në fushën e ndërtimit me fonde publike.

Moszbatimi i përcaktimeve të VKM 42 /2008, KREU III, pika 1 paragrafi II.b, i ndryshuar, do të ishte shkelje e parimit të ligjshmerisë si dhe parimeve të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmerisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Moszbatimi i percaktimeve te VKM 42 /2008 KREU III, pika 1 paragrafi II.b, i ndryshuar, do te konsiderohej vleresim siperfaqesor e formal i kriterëve per kualifikim, nderkohe qe KVO ka detyrimin qe te beje analize ne themel dhe te arsyeshme te kriterëve per kualifikim ne harmoni me bazen ligjore te aplikueshme per rastin e zbatimit te punimeve ne ndertim ne kontratat te lidhura ne perfudim te procedurave te prokurimit te fondeve publike.

Fakti qe ARRSH eshte koherente dhe e qendrueshme ne perdorimin e kesaj arsyeje skualifikimi eshte detyrim i saj ligjor qe rrjedh jo vetem nga fuqia detyruese e percaktimeve te VKM 42/2008, por edhe detyrimi i zbatimit te rendesishem te parashikuar nga K Pr Administrative si dhe LPP per qendrueshmerine ne vendimarrje.

Nqs nga ana e ARRSH-se ne procedura te caktuara apo per operatore te caktuar do te zbatohet percaktimi I Kreu III, pika 1, paragrafi II b **te VKM** nr 42, date 16.01.2008, i ndryshuar kurse ne disa raste tjera apo operatore te tjere nuk do te zbatohet, **kjo do te ishte ne kundërshtim flagrant me percaktimet e neneve, 11/Ç (parimi i ushtrimit te ligjshem te diskrecionit), 13 (parimi i drejtesie dhe paanesise) e 17 (parimi i barazise dhe mosdiskriminimit) te K Pr Administrative.**

Konkretisht ne neni 11/Ç K PR A shprehimisht percaktohet :

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

.....

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme

Edhe ne rastin e supozuar se KVO nuk do te zbatonte percaktimet e VKM 42 /2008 , KREU III, pika 1, paragrafi II.b, i ndryshuar, perseri ky BO qe ka pjese nje operator qe ka te paperfunduara 70 % te volumit te kontrates qe ka me ARRSH-ne do te ishte e pamundur te shpallej fitues e te lidhte kontrate me ARRSH-ne .

Kjo, sepse percaktimet e mesiperme parashikojne jo vetem skualifikim, por **ne çdo kohe edhe pas lidhjes se kontrates ajo do te konsiderohej absolutisht e pavlefshme dhe efektet e e vleresimit te KVO-se do te ishin nul dhe pa asnje pasoje juridike.**

Do te mjaftonte ankimi, por qofte edhe thjesht nje kerkese per konstatim pavlefshmerie absolute i cilido operatori apo subjekti tjetër te interesuar per kete procedure qe ARRSH apo Gjykata te detyrohej dhe konstatohej *nuliteti* (pavlefshmeria absolute) i fituesit dhe kontrates se lidhur (*neni 108 i K Pr Administrative*).

... citoj *„Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose **KONTRATA TË SHPALLET ABSOLUTISHT E PAVLEFSHME**, ME DETYRIMIN PËR NJOFTIM PËR NISJE TË PROCEDURËS PËR HEQJE LICENCE”*.

Referuar percaktimeve të VKM 42/2008 operatori që nuk ka perfunduar 70 % të punëve të kontraktuara jo vetëm duhet të skualifikohet apo kontrata t’i shpallet absolutisht e pavlefshme, por ARRSH-se i është ngarkuar edhe detyrimi për të bërë njoftim për fillimin e procedurës për heqje licence të cilido operatori që shpallet fitues lidh kontratë tjetër pa perfunduar 70 % të punimeve të kontratës që ka me ARRSH-ne.

3.1 Një nga pjesëtarët e këtij BO, operatori GPG Company shpk nuk arrin të paraqesë dokumentacion të saktë për të deshmuar plotësimin e pikës 1.2.2 të kritereve të veçanta për kualifikim (*operatori GPG Company shpk nuk ka arritur të paraqesë kontratë për realizim pune ngjashme gjatë tre viteve të fundit siç kërkohej në DT*).

Për të deshmuar plotësimin e këtij kriteri, operatori GPG shpk ka paraqitur kontratën Ndërtim rruga Lushnjë Berat, kontratë bazë dhe kontratë shtesë. Krahas kontratës, operatori ka paraqitur edhe dokumentacionin shtesë si formular vlerësimi, fatura tatimore dhe akt kolaudimin.

Por pikërisht në këto dokumenta deshmohet se punimet janë realizuar jashtë afatit tre vjeçar të kërkuar në DT dhe kontrata ka perfunduar më datën 30.12.2015 .

Faturat tatimore të paraqitura deshmojnë se gjatë vitit 2016 janë kryer punime dhe faturuar në vlerën (*fatura nr 11 dt 28.01.2016 , fatura 21 dt 11.02.2016 dhe fatura 22 dt 11.02.2019 përkatësisht në vlera 3 500 000 leke , 4 457 986 leke dhe 3 182 323 leke*).

Në përlogaritjen e këtij afati trevjeçar, KVO i referohet praktikës së vendimmarrjeve të **KPP** siç është rasti i K.P.P. 521/2016, K.P.P. 874/2016 etj.

Në pikën 3 të VKM 914/2014 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

Duke qenë se, një prej pjesëtarëve të këtij BO, konkretisht, operatori GPG Company shpk nuk ka arritur të deshmojë eksperiencën të ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit në vlerat e kërkuara në pikën 1.2.2 të kritereve të veçanta për kualifikim dhe duke e konsideruar këtë mangësi thelbësore, kjo ofertë e BO 2 T shpk dhe GPG Company shpk duhet të

skualifikohet pa qene nevoja per shqyrtim e vleresim te kushteve te tjera te parashikuara ne DT .

3.2 Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë **“2T” shpk & “GPG Company” shpk** janë krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit nr. 4042 repertori dhe nr. 1688 koleksioni. Referuar elementëve konkretë të bashkëpunimit rezulton se anëtari i BOE “GPG Company” sha ka marrë përsipër 58.1% të punimeve dhe konkretisht:

me vlerat përaktëse sipas preventivit të dorëzuar:

Aksi 7B	13,745,219.40
Punime Pilota për Ujërat nëntokësorë ShC	3,000,000
Punime Strukturash Sh D	991,876,436
Punime Hidroteknike ShE	15,565,330
Punime për veprat e ujitjes Sh H	7,881,550
Sinjalistika ndricuese Sh1+J2	3,927,700
Punime Gjelberimi K1+K2+K3+K4	3,773,000
PA TVSH	1,039,769,235.40
3%	31,193,077.06

TOT PA TVSH	1,070,962,312.46
OFERTA PA TVSH	1,849,345,584.82

% 0.579103398

TOT ME TVSH 1,285,154,774.95

PAISJE ME TVSH 1,991,000

TOT ME TVSH 1,287,145,774.954

OFERTA ME TVSH 2,218,816,501.78

% 0.580104652

Pra, referuar Formularit të Ofertës, rezulton që anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “GPG COMPANY” SHPK ka marrë përsipër referuar Preventivit **57.9 % të punimeve pa TVSH dhe 58 % të punimeve me TVSH**, e cila është më e vogël se **58.1 %** që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM 914/2014 e cila parashikon se “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të*

bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se, bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Sa më sipër anëtari i BOE ka marrë përsipër kryerjen e shërbimit në një vlerë më të vogël se angazhimi i marrë përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit, çka bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM. Të nëjtin qëndrim ka mbajtur KPP edhe në Vendimet KPP 823/2016, KPP

3.3 Në nenin 45 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar parashikohet se: " Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij" Në shtojcën 8 "Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit" parashikohet se: • Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë. Anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë "GPG Company" shpk ka dorëzuar shtojcën 8 "Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit" ku ka deklaruar se vetëm z. Gezim Dani nuk ka qenë i dënuar me vendim të të formës së prerë. Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin e Regjistrat Tregtar rezulton se administrator i shoqërisë dhe njëkohësisht ortak në 50 % është edhe z. Paqsor Buzi. Sa më sipër anëtari i BOE "GPG Company" shpk nuk ka deklaruar se të gjithë aksionerët dhe administratorët të cilët kanë kompetenca përfaqësuese nuk kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë në përputhje me nenin 45 të ligjit për prokurimin publik dhe shtojcës 8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit. Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar ku parashikohet se: "*1. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të*

përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.”

4. Skualifikim te BO Gjoka sha & Shansi Invest shpk, sepse nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kritereve te kerkuara ne DT dhe baze ligjore ne fuqi te aplikueshme sipas rregullave te prokurimit dhe LPP.

Konkretisht:

*1.1 Nje nga pjesetaret e ketij BO, me informacionin qe disponohet zyrtarisht ne ARRSH, ne momentin e hapjes se ofertave si dhe ne daten e vleresimit rezulton se operatori Gjoka sha ka aktualisht me ARRSH-ne te paperfunduar ne 70 % te volumit te punimeve te parashikuara ne kontraten me objekt : “**Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4,***

*Edhe vete operatori Gjoka sha ne deklarimin e bere pranon e pohon se eshte duke zbatuar punimet ne kontraten me objekt “**Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4**” si pjese e BO me Cobial shpk dhe nuk pretendon se i ka perfunduar ato ne me shume se 70 % te volumit te parashikuar ne kontrate.*

ARRSH eshte e detyruar qe te zbatoje percaktimet ligjore ne fuqi te parashikuara ne VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku ne menyre eksplicite e perjashtimisht nga çdo AK, por vetem per ARRSH-ne, eshte percaktuar detyrimi qe I ndalohe te kualifikoje e shpalle fitues operatore te cilet kane ne proces me ARRSH duke zbatuar kontrate dhe nuk i kane perfunduar punimet ne 70 % te vleres se kontrates.

*Ne VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, shprehimisht thuhet “Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila **ndalohe** të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, **kontraktorë**, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një **kontrate të lidhur** apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili **nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor**, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.*

Skualifikimi per kete arsye te mosperfundimit te 70 % te volumit te puneve ne kontraten qe ka

aktualisht me ARRSH-ne eshte detyrim ligjor per KVO-ne, jo vetem sepse eshte parashikuar ne piken 2.3.1 te kriterave te vecanta per kualifikim, por edhe sepse eshte nje praktike e konsoliduar e vendimarrjeve te ARRSH-se edhe ne procedura te meparshme prokurimi.

Keshtu nga referimi ne percaktimet e VKM nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, jane skualifikuar ne disa proceduara prokurimi te zhvilluara nga ARRSH-ja, operatore qe kane patur diference me operatorin e shpallur fitues pikerisht, sepse kane qene me kontrata me ARRSH dhe te paperfunduara ne 70 % te vleres se kontrates.

Nqs ne proceduren aktuale nuk do te zbatohet ky kriter per skualifikim, cka do te thoshte qe aplikimi i 70 % te behej ne disa proceduara dhe ne disa jo, do te perbente ne thelb cenim te parimit te nje procesi te rregullt ligjor e administrative sepse do te cenohej parimi i sigurise juridike.

Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se **“Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”.**

Ne rastin konkret, parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscënimi i pritshmërive të ligjshme te operatoreve te ndryshem qe marrin pjese ne procedure duke iu referuar praktikës dhe akteve te meparshem te ARRSH-se per skualifikim te operatoreve qe kane te paperfundura 70 % te vleres kontrates me ARRSH.

Mosaplikimi i percaktimeve te 70 % do te ishte ne kundërshtim flagrant me percaktimet e nenit 4 te K PR Administrative (*Parimi i ligjshmerise*).

Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike siç është edhe ARRSH-ja .

Ky parim nenkupton ne rastin konkret, se zhvillimi i procedurave te prokurimit dhe ne menyre te vecante ai i vleresimit te ofertave do te zhvillohet ne harmoni, ne koherence te plote logjike e ligjore mes dispozitave te LPP dhe rregullave te prokurimit me dispozitat e tjera me te cilat lidhet procedura e prokurimit e siç eshte rasti i VKM nr 42 /2008. Kjo VKM nr 42 si akt normativ ka lidhje te ngushte dhe organike me procesin e vleresimit te ofertave, sepse lidhet me kapacitetet teknike e profesionale qe duhet te disponoje operatori qe zbaton punime ne fushen e ndertimit me fonde publike.

Moszbatimi i percaktimeve te VKM 42 /2008, KREU III, pika 1 paragrafi II.b, i ndryshuar, do te ishte shkelje e parimit te ligjshmerise si dhe parimeve te mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Moszbatimi i percaktimeve te VKM 42 /2008 KREU III, pika 1 paragrafi II.b , i ndryshuar, do

te konsiderohej vleresim siperfaqesor e formal i kriterëve për kualifikim ndërkohë që, KVO ka detyrimin që të bëjë analizë në themel dhe të arsyeshme të kriterëve për kualifikim në harmoni me bazën ligjore të aplikueshme për rastin e zbatimit të punimeve në ndërtim në kontratat të lidhura në përfundim të procedurave të prokurimit të fondeve publike

Fakti që ARRSH është koherente dhe e qëndrueshme në përdorimin e kësaj arsyeje skualifikimi është detyrim i saj ligjor që rrjedh jo vetëm nga fuqia detyruese e përcaktimeve të VKM 42/2008, por edhe detyrimi i zbatimit të rendesishëm të parashikuar nga K Pr Administrative si dhe LPP për qëndrueshmërinë në vendimarrje.

Nqs nga ana e ARRSH-se në procedura të caktuara apo për operatorë të caktuar do të zbatohet përcaktimi I Kreu III, pika 1, paragrafi II b **te VKM** nr 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar kurse në disa raste tjera apo operatorë të tjerë nuk do të zbatohet, **kjo do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e nënëve, 11/Ç (parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit), 13 (parimi i drejtësisë dhe paanësisë) e 17 (parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit) të K Pr Administrative.**

Konkretisht në nenin 11/Ç K PR A shprehimisht përcaktohet ;

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

.....

ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme

Edhe në rastin e supozuar se KVO nuk do të zbatonte përcaktimet e VKM 42 /2008, KREU III, pika 1, paragrafi II.b, i ndryshuar, perseri ky BO që ka pjesë një operator që ka të përfunduar 70 % të volumit të kontratës që ka me ARRSH-ne do të ishte e pamundur të shpallë fitues e të lidhte kontratë me ARRSH-ne.

Kjo, sepse përcaktimet e mësipërme parashikojnë jo vetëm skualifikim, por **në çdo kohë edhe pas lidhjes kontratës ajo do të konsiderohej absolutisht e pavlefshme dhe efektet e e vleresimit të KVO-se do të ishin nul dhe pa asnjë pasoje juridike.**

Do të mjaftonte ankimi, por qoftë edhe thjesht një kërkesë për konstatim pavlefshmerie absolute i cilitdo operatori apo subjekti tjetër të interesuar për këtë procedurë që ARRSH apo Gjykata të detyrohej dhe konstatohej *nuliteti* (pavlefshmeria absolute) i fituesit dhe kontratës së lidhur (*neni 108 i K Pr Administrative*).

... citoj *„Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit*

*dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose **KONTRATA TË SHPALLET ABSOLUTISHT E PAVLEFSHME**, ME DETYRIMIN PËR NJOFTIM PËR NISJE TË PROCEDURËS PËR HEQJE LIÇENCE”.*

Referuar percaktimeve të VKM 42/2008, operatori që nuk ka perfunduar 70 % të punëve të kontraktuara jo vetëm duhet të skualifikohet apo kontrata t’i shpallet asolutisht e pavlefshme, por ARRSH-se i është ngarkuar edhe detyrimi për të bërë njoftim për fillimin e procedurës për heqje liçence të cilido operatori që shpallet fitues lidh kontratë tjetër pa perfunduar 70 % të punimeve të kontratës që ka me ARRSH-ne.

Për sa më sipër, KVO nuk e konsideron të nevojshëm shqyrtimin e metejshëm të dokumentacionit tjetër të paraqitur nga ky BO, sepse arsyeja e mesipërme është detyrim ligjor për skualifikim të BO ku bën pjesë Gjoka sha, i cili nuk ka perfunduar 70 % të volumit të punimeve të kontratës **“Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4” të cilën është duke e realizuar aktualisht me ARRSH-ne.**

4.1 Në nenin 45 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij” Në shtojcën 8 “Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të Kualifikimit/Pranimit” parashikohet se:

- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë.

Nga verifikimet e kryera rezulton se anëtari i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Shansi Invest” shpk ka dorëzuar shtojcën 8 jo në përputhje me shtojcën në dokumentet e procedurës së prokurimit, pasi nuk ka deklaruar Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë.

Nga verifikimet e kryera anëtari i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sha ka dorëzuar shtojcën 8 ku ka deklaruar vetëm se z. Rrok Gjoka nuk ka qenë i dënuar më parë

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin e Regjistrimit Tregëtar rezulton se shoqëria “Gjoka Konstruktion” sha është shoqëri administrimi me dy nivele dhe se anëtarët vendimarrës të Këshillit Mbikqyrës, Erind Gjoka, Elvis Gjoka dhe Feride Gjoka nuk janë deklaruar se nuk kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë në përputhje me nenin 45 të ligjit për prokurimin publik dhe shtojcës 8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 3 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.”

4.2 Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Gjoka” shpk & “Shansi Invest” shpk janë krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit nr. 1020 repertori dhe nr. 533 koleksioni. Referuar elementëve konkretë të bashkëpunimit rezulton se anëtari i BOE “Shansi Invest” shpk ka marrë përsipër 5.3 % të punimeve dhe konkretisht:

Në linjën A1 deri në Linjën A6 të gjithë zërat pa zërin për punime betoni me vlerë totale 8,649,650 lekë pa TVSH

Tunele T1 deri në T6 me vlerë 18,466,080 lekë pa TVSH

Shumën F1+F2 pa zërat, 1,2,9 tek seksioni Linja Rezervë për rrugën dytësore me vlerë 75,047,198 lekë pa TVSH

Shumën J1+J2 me vlerë 19,485,300

Tek Shumë K3 punimet në zërat nga 24 deri në 33 total 100,550

Dhe paisjet me vlerë 8,868,000

Totali pa TVSH 121,728,778

X 3% = 3,651,863.34

Totali = 125,380,641.34

% 1,924,025,051.67

= 6.51 %

Totali me TVSH = 150,456,769.608

Paisje 8,868,000

TOTALI ME TVSH +PAISJE 159,324,769.608

% 2,307,506,462

=6.9 %

Pra, referuar Formularit të Ofertës, rezulton që anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Shasni Invest” shpk ka marrë përsipër referuar Preventivit 6.51 % të punimeve pa TVSH dhe 6.9 % to totalit të punimeve me TVSH e cila është më e madhe se 5.3% që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM 914/2014 e cila parashikon se “*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të*

bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Sa më sipër anëtari i BOE ka marrë përsipër kryerjen e shërbimit në një vlerë më të madh se angazhimi i marrë përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit çka bie në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP edhe në Vendimet KPP 823/2016, KPP

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve **“SALILLARI” SH.P.K & “BAJRAMI N” SH.P.K**, me adrese **Rruga e Vjeter Vore – Tirane km 1**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1.776.111.282 (një miliard e shtateqind e shtatedhjetë e gjashtë milion e njëqind e njembëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa rruga “Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Fax +355 4 2234789 / +355 4 2223600, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme 1.786.834.087 (një miliard e shtateqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e teteqind e tridhjetë e kater mijë e tetëdhjetë e shtate) leke pa tvsh, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.08.2019

Ankesa : Ka patur ankesa dhe operatoreve ekonomike u eshte kthyer pergjigje me date 16.08.2019.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergys Verdho